

LIGJ
Nr. 49/2025

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS,
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË BULLGARISË, QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
KROACISË, QEVERISË SË HUNGARISË, QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT, QEVERISË SË MALIT TË ZI, QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SERBISË, QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVAKISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË PËR BASHKËPUNIMIN DHE
KOORDINIMIN NË FUSHËN E KËRKIMIT DHE SHPËTIMIT AJROR,
NËNSHKRUAR NË OHËR, MË 22.2.2023**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, qeverisë së Republikës së Bullgarisë, qeverisë së Republikës së Kroacisë, qeverisë së Hungarisë, qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, qeverisë së Malit të Zi, qeverisë së Republikës së Serbisë, qeverisë së Republikës së Sllovakisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovenisë për bashkëpunimin dhe koordinimin në fushën e kërkimit dhe shpëtimit ajror, nënshkruar në Ohër, më 22.2.2023, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 3.7.2025.

Shpallur me dekreten nr. 244, datë 10.7.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS,
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË BULLGARISË, QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË,
QEVERISË SË HUNGARISË, QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT,
QEVERISË SË MALIT TË ZI, QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË, QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SLLOVAKISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË, PËR
BASHKËPUNIMIN DHE KOORDINIMIN NË FUSHËN E KËRKIMIT DHE SHPËTIMIT
AJROR

Këshilli i Ministrave i Bosnjës dhe Hercegovinës, qeveria e Republikës së Bullgarisë, qeveria e Republikës së Kroacisë, qeveria e Hungarisë, qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, qeveria e Malit të Zi, qeveria e Republikës së Serbisë, qeveria e Republikës së Sllovakisë dhe qeveria e Republikës së Sllovenisë (në vijim të referuar si “palët”),

duke marrë në konsideratë se Konventa për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, e hapur për nënshkrim në

Çikago më 7 dhjetor 1944 (*në vijim e referuar si "Konventa e Çikagos"*) dhe anekset e saj përcaktojnë kuadrin bazë për sistemin ndërkombëtar të aviacionit civil, në lidhje me operacionet e kërkimit dhe shpëtimit (*në vijim e referuar si "SAR"*);

duke njohur rëndësinë e operacioneve SAR për lokalizimin dhe shpëtimin e personave në rrezik, sigurimin e ndihmës së parë mjekësore ose të nevojave të tjera emergjente dhe transportimin e tyre në një vend të sigurt;

duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e masave të menjëhershme të shpëtimit për garantimin e jetës së personave në rrezik;

duke njohur nevojën për pajtueshmëri të plotë me standardet dhe praktikrat e rekomanduara të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (*në vijim të referuara si "ICAO SARPS"*) në fushën e SAR-it, të përcaktuara në aneksin 12 të Konventës së Çikagos mbi Kërkimin dhe Shpëtimin (*në vijim i referuar si "aneksi 12"*), si dhe të zhvilluara më tej në Manualin Ndërkombëtar të Kërkimit dhe Shpëtimit Ajror dhe Detar (IAMSAR) dhe dokumente të tjera përkatëse SAR (*në vijim të referuara si "dispozitat ndërkombëtare SAR"*);

duke pasur parasysh se aneksi 12 është i zbatueshëm për krijimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e shërbimeve SAR brenda territoreve të shteteve të palëve dhe në hapësirat detare ndërkombëtare, si dhe për koordinimin efektiv të këtyre shërbimeve ndërmjet shteteve;

duke marrë në konsideratë standardet dhe praktikrat e rekomanduara të ICAO-s, të përcaktuara në aneksin 9 të Konventës së Çikagos mbi Lehtësimin, veçanërisht kapitullin 8 që trajton, ndër të tjera, lehtësimin e operacioneve të kërkimit dhe shpëtimit;

duke njohur nevojën për harmonizimin dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht në nivel rajonal, për organizimin dhe zhvillimin e operacioneve SAR dhe për trajnimin përkatës të personelit;

duke in referuar dispozitave të përcaktuara në Memorandumin e Mirëkuptimit (në vijim i referuar si "MM"), të nënshkruar më 3 nëntor 2016, në Beograd, për krijimin e Komitetit Këshillues Rajonal për SAR Ajror;

duke marrë në konsideratë se palët e kësaj marrëveshjeje janë, njëkohësisht, anëtarë ose vëzhgues të Komitetit Këshillues Rajonal për SAR-in Ajror,

bien dakord, si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

Kjo marrëveshje përcakton kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet palëve për zhvillimin e operacioneve të kërkimit dhe shpëtimit ajror (SAR) dhe përcakton përgjegjësitë e tyre përkatëse, me qëllim përmbytjen e plotë të detyrimeve të tyre, siç parashikohen në standardet dhe praktikrat e rekomanduara të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO SARPs).

Palët bien dakord që operacionet e SAR-it ajror në ose mbi detin territorial, ujërat e brendshme dhe territorin tokësor të secilit shtet palë, do të kryhen në përputhje me legjislacionin kombëtar ose aktet ligjore në fuqi në territorin e shteteve përkatëse, duke marrë parasysh dispozitat ndërkombëtare përkatëse në fushën e SAR.

Palët angazhohen që të garantojnë koordinim të ngushtë me autoritetet e tyre kombëtare për SAR-in ajror, me qëllim forcimin e shërbimeve të përbashkëta dhe efektive të SAR-it, në kuadër të kësaj marrëveshjeje. Në këtë kuadër, palët do të ndihmojnë njëra-tjetrën, sipas mundësive, në zhvillimin e operacioneve SAR, duke autorizuar qendrat e koordinimit të shpëtimit (në vijim: RCC-të) që të kërkojnë ndihmë nga RCC-ja e palës tjetër ose të përgjigjen pa vonesë ndaj thirrjeve të emergjencës dhe kërkesave për ndihmë nga RCC-ja e palës tjetër.

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, termat dhe përkufizimet do të kenë kuptimin e përcaktuar në kapitullin 1, të aneksit 12 të Konventës së Çikagos.

Neni 2

Rajonet SAR

Për qëllime të operacioneve të kërkimit dhe shpëtimit ajror, kufijtë e rajoneve fqinjësore të SAR-it, në

parim dhe në masën e mundur, duhet të përkojnë me kufijtë përkatës ndërmjet rajoneve të informacionit të fluturimit të shteteve palë (në vijim "FIR").

Në rastet kur kufijtë e FIR-ve dhe rajoneve SAR nuk përkojnë, palët e përfshira do të rregullojnë çështjen nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe të veçanta. Palët që nënshkruajnë marrëveshje të tilla, duhet të informojnë me rrugë diplomatike për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme. Autoriteti përgjegjës për këtë marrëveshje do të njoftojë të gjitha palët për lidhjen e çdo marrëveshjeje dypalëshe.

Përcaktimi i rajoneve SAR ndërmjet palëve, siç parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, synon garantimin e disponueshmërisë së shërbimeve SAR, përmirësimin dhe thjeshtimin e operacioneve SAR, si dhe lehtësimin e shpërndarjes së duhur të sinjaleve të emergjencës në RCC-të përkatëse. Ky përcaktim nuk lidhet dhe nuk cenon kufizimet e tjera territoriale ndërmjet palëve.

Neni 3

Autoritetet përgjegjëse

Autoritetet kompetente për kërkimin dhe shpëtimin ajror, përfshirë qendrat e koordinimit të shpëtimit ajror (RCC-të) dhe qendrat e koordinimit të shpëtimit detar (në vijim MRCC-të) të palëve, janë listuar në aneksin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 4

Komunikimi dhe bashkëpunimi

Për të garantuar koordinimin e duhur të operacioneve të kërkimit dhe shpëtimit (SAR), palët do të mbajnë njëra-tjetrën të informuara në mënyrë të plotë dhe të menjëhershme. Nëse RCC-ja e një shteti palë vlerëson se ka nevojë për ndihmën e RCC-së së një shteti tjetër palë, ajo mund të kërkojë një ndihmë të tillë.

Në rast se RCC-ja e një shteti palë merr informacion se një jetë njerëzore është ose dyshohet të jetë në rrezik brenda rajonit SAR të një shteti tjetër palë, ajo do të njoftojë pa vonesë RCC-në përkatëse të shtetit në fjalë.

Ndihma për çdo mjet ajror që ndodhet ose dyshohet se ndodhet në rrezik, si dhe për të mbijetuarit e një aksidenti ajror brenda rajonit SAR të një shteti palë, do të ofrohet pavarësisht nga shteti i regjistrimit ose statusi i mjetit ajror, kombësia apo statusi i personave në bord, apo rrethanat në të cilat ndodhet mjeti ajror ose personat e prekur.

Neni 5

Lehtësimi i tranzitit përmes territorit të shteteve të palëve

Në përputhje me kushtet e parashikuara në aneksin 12, çdo palë do të lejojë hyrjen emergjente dhe tranzitin e menjëhershëm të njërive SAR të një pale tjetër përmes ose mbi detin territorial, ujërat e brendshme dhe territorin tokësor të saj, me qëllim zhvillimin e operacioneve të kërkimit dhe shpëtimit.

Neni 6

Marrëveshjet operacionale

Autoritetet përgjegjëse, siç përcaktohen në aneksin e kësaj marrëveshjeje, do të lidhin marrëveshje operacionale dypalëshe për bashkëpunimin në zbatimin praktik të kësaj marrëveshjeje me autoritetet përkatëse të shteteve fqinje palë të kësaj marrëveshjeje. Ky bashkëpunim do të përfshijë, ndër të tjera, organizimin e stërvitjeve të përbashkëta SAR dhe trajnimeve, verifikimin periodik të kanaleve të komunikimit, vizita të ndërsjella nga ekspertët SAR, shkëmbimin e informacionit, procedurave, teknikave dhe përvojave në fushën e SAR-it, si dhe koordinimin e qëndrimeve kombëtare për çështje ndërkombëtare të SAR-it me interes të ndërsjellë.

Palët do të përcaktojnë në marrëveshjet operacionale procedurat e nevojshme për të garantuar metodat më efektive dhe efikase të komunikimit.

Autoritetet përgjegjëse do të përcaktojnë masa të detajuara në marrëveshjet operacionale për të

lehtësuar kalimet kufitare, ndalesat tranzit në territorin e një shteti tjetër palë, si dhe importin/eksportin e përkohshëm të mjeteve ajrore, veglave, pjesëve të këmbimit dhe pajisjeve të nevojshme për operacionet e kërkimit dhe shpëtimit.

Importimi i përkohshëm i artikujve të përshkruar më sipër do të përjashtohet nga detyrimet doganore, taksat e importit dhe çdo tarifë tjetër doganore apo tatim mbi vlerën e shtuar, në përputhje me legjislacionin kombëtar të palëve.

Përveç rasteve kur palët bien dakord ndryshe në marrëveshjet operacionale, transportimi i armëve, municioneve dhe lëndëve plasëse nuk lejohet gjatë operacioneve SAR të zhvilluara në bazë të kësaj marrëveshjeje.

Neni 7 **Shpenzimet**

Palët do të përcaktojnë çështjen e mbulimit të shpenzimeve të shkaktuara nga pjesëmarrja e tyre në operacionet e kërkimit dhe shpëtimit (SAR) në marrëveshjet operacionale, në përputhje me legjislacionin kombëtar ose aktet ligjore në fuqi në territorin e shteteve përkatëse të palëve.

Nëse çështja e mbulimit të shpenzimeve nuk është përcaktuar në marrëveshje operacionale ose në marrëveshjet dypalëshe, secila palë do të mbulojë shpenzimet e kryera nga pjesëmarrja e saj në operacionet SAR, në përputhje me këtë marrëveshje.

Në rast se gjatë një operacioni SAR, të zhvilluar në përputhje me këtë marrëveshje, shkaktohet dëm ndaj një pale të tretë, përgjegjësia për mbulimin e dëmit do të mbetet tek pala që ka kërkuar ndihmën, njëjloj sikur dëmi të ishte shkaktuar nga anëtarët e njësisë të saj SAR të angazhuara në operacion, me përjashtim të rasteve kur dëmi është shkaktuar me dashje ose për shkak të neglizhencës së rëndë.

Neni 8 **Të drejtat dhe detyrimet**

Asnjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje nuk do të cenojë në asnjë mënyrë të drejtat dhe detyrimet e ndonjërës prej palëve, të cilat rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare ose nga marrëveshje të tjera ndërmjet palëve.

Palët nuk mund të transferojnë të drejtat, detyrimet apo pjesëmarrjen e tyre në këtë marrëveshje tek ndonjë subjekt tjetër, pa pëlqimin e shprehur të të gjitha palëve.

Të gjitha aktivitetet e zhvilluara në bazë të kësaj marrëveshjeje, do t'i nënshtrohen rregullave dhe politikave të shteteve të palëve, si dhe të gjitha ligjeve, rregulloreve dhe politikave përkatëse që zbatohen ndaj palëve.

Neni 9 **Konsultimet**

Në frymën e bashkëpunimit të ngushtë, secila palë do të konsultohet periodikisht me palët e tjera për të garantuar zbatimin e duhur të dispozitave të kësaj marrëveshjeje dhe të aneksit të saj. Çdo palë mund të kërkojë në çdo kohë konsultime mbi zbatimin, interpretimin, aplikimin ose ndryshimin e kësaj marrëveshjeje. Asnjë mosmarrëveshje nuk do të referohet për zgjidhje në ndonjë organ ndërkombëtar ose tek ndonjë palë e tretë.

Këto konsultime mund të zhvillohen nëpërmjet diskutimeve ose korrespondencës dhe do të nisin brenda një periudhe prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e marrjes së një kërkesë të tillë, përveç rasteve kur palët bien dakord ndryshe.

Neni 10 **Ndryshimi i marrëveshjes**

Nëse ndonjë palë e çmon të nevojshme ndryshimin e ndonjë dispozite të kësaj marrëveshjeje, një ndryshim i tillë do të bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 9. Ky ndryshim do të hyjë në fuqi pasi palët

të kenë njoftuar njëra-tjetrën, përmes kanaleve diplomatike, për përmbushjen e procedurave të tyre të brendshme ligjore, në lidhje me miratimin dhe hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.

Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, secila palë mund të ndryshojë autoritetet e saj për SAR-in, të listuara në aneksin e kësaj marrëveshjeje. Një ndryshim i tillë do të hyjë në fuqi pasi kjo palë të njoftojë palët e tjera përmes kanaleve diplomatike mbi ndryshimin e aneksit.

Termi **“Marrëveshje”** nënkupton këtë marrëveshje, aneksin e saj, si dhe çdo ndryshim të bërë në marrëveshje ose në aneks. Termi **“Aneks”** nënkupton listën e autoriteteve SAR, listën e RCC-ve dhe/ose MRCC-ve të shteteve palë.

Neni 11

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe tërheqja

Kjo marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit, pranimi ose miratimit nga palët, në përputhje me legjislacionet e tyre kombëtare përkatëse.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas datës kur pala e tretë ka dorëzuar instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit pranë depozitarit.

Për çdo palë që ratifikon, pranon ose miraton këtë marrëveshje pas hyrjes së saj në fuqi, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, marrëveshja hyn në fuqi për atë palë ditën e parë të muajit pas dorëzimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit.

Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe.

Çdo palë mund të tërhiqet nga kjo marrëveshje në çdo kohë, duke dorëzuar një njoftim me shkrim për tërheqjen pranë depozitarit. Tërheqja hyn në fuqi gjashtë muaj pas marrjes së njoftimit nga depozitari.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje ndërmjet dy ose më shumë palëve, lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje, palët e përfshira do të kërkojnë një zgjidhje përmes konsultimeve dhe negociatave të ndërsjella dhe nuk do t'ia referojnë çështjen për zgjidhje ndonjë organi ndërkombëtar ose pale të tretë.

Neni 13

Aderimi

Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, ajo do të mbetet e hapur për aderim.

Për çdo shtet aderues, kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas depozitimit të instrumentit të tij të aderimit pranë depozitarit.

Çdo shtet aderues do të jetë shtet kontraktues i Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO).

Neni 14

Depozitari

Qeveria e Republikës së Serbisë do të veprojë si depozitari i kësaj marrëveshjeje.

Pas hyrjes së saj në fuqi, në përputhje me dispozitat e paragrafit 2, të nenit 11, kjo marrëveshje dhe çdo ndryshim i saj do të regjistrohen nga depozitari pranë Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO).

Neni 15

Dispozita përfundimtare

Në rast se lind nevoja për shkëmbimin e informacionit sensitiv, palët mund të ndjekin si udhëzues Politikën mbi Konfidencialitetin, Mbrojtjen dhe Përdorimin e Duhur të Informacionit të Komitetit

Këshillues Rajonal për Kërkimin dhe Shpëtimin Ajror.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar plotësisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Originali i kësaj marrëveshjeje, i hartuar në një kopje të vetme në gjuhën angleze, do të depozitohet pranë autoritetit administrues, i cili do të transmetojë një kopje të vërtetuar për secilën palë.

Hartuar në Ohër, më 22.2.2023.

Nënshkruesit:

Për Këshillin e Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës;

Për qeverinë e Malit të Zi;

Për qeverinë e Republikës së Bullgarisë;

Për qeverinë e Republikës së Serbisë;

Për qeverinë e Republikës së Kroacisë;

Për qeverinë e Republikës së Sllovakisë;

Për qeverinë e Hungarisë;

Për qeverinë e Republikës së Sllovenisë;

Për qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

ANEKS

AUTORITETET SAR, RCC-të DHE MRCC-të

Bosnja dhe Hercegovina:

- **Autoriteti për Kërkim dhe Shpëtim Ajror (SAR):** Drejtoria e Aviacionit Civil e Bosnjës dhe Hercegovinës (BHDA);

- **RCC:** Qendra e Koordinimit të Shpëtimit të Bosnjës dhe Hercegovinës (BHRCC), Agjencia e Shërbimeve të Navigimit Ajror të Bosnjës dhe Hercegovinës (BHANS).

Republika e Bullgarisë:

- **Autoriteti për Kërkim dhe Shpëtim Ajror (SAR):** Drejtoria e Përgjithshme e Administratës së Aviacionit Civil të Republikës së Bullgarisë;

- **RCC:** RCC Varna.

Republika e Kroacisë:

- **Autoriteti për Kërkim dhe Shpëtim Ajror (SAR):** Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kroacisë;

- **RCC:** Qendra Operative, Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kroacisë;

- **MRCC:** MRCC Rijeka.

Hungaria:

- **Autoriteti për Kërkim dhe Shpëtim Ajror (SAR):** Ministria e Punëve të Brendshme e Hungarisë;

- **RCC:** Komanda dhe Qendra e Kontrollit të Operacioneve Ajrore të Forcave të Mbrojtjes të Hungarisë, Qendra e Operacioneve Ajrore.

Republika e Maqedonisë së Veriut:

Autoriteti për Kërkim dhe Shpëtim Ajror (SAR): Agjencia e Aviacionit Civil të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

RCC: RCC Shkup.

Mali i Zi:

- **Autoriteti për Kërkim dhe Shpëtim Ajror (SAR):**

- **Për operacionet në tokë:**

- Ministria e Punëve të Brendshme e Malit të Zi;

- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim;

- Departamenti 112 - Qendra Operative e Komunikimit 112;

- **Për operacionet në det:**

- Ministria e Investimeve Kapitale e Malit të Zi;

- Administrata për Sigurinë Detare dhe Menaxhimin e Porteve;

- Sektori për Sigurinë e Navigimit;

- Për mbikëqyrjen e SAR:

- Agjencia e Aviacionit Civil e Malit të Zi.

- **RCC:** Qendra Operative e Komunikimit 112 - Qendra e Koordinimit të Shpëtimit Ajror e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

- **MRCC:** Qendra e Koordinimit të Shpëtimit Detar e Administratës për Sigurinë Detare dhe Menaxhimin e Porteve pranë Ministrisë së Investimeve Kapitale.

Republika e Serbisë:

- **Autoriteti për Kërkim dhe Shpëtim Ajror (SAR):** Drejtoria e Aviacionit Civil e Republikës së Serbisë;

- **RCC:** Qendra e Koordinimit të Shpëtimit, Beograd, pranë Drejtorisë së Aviacionit Civil të Republikës së Serbisë.

- Republika e Sllovakisë:

- **Autoriteti për Kërkim dhe Shpëtim Ajror (SAR):** (do të përcaktohet në vijim, në përputhje me dispozitat e nenit 10 (2) të kësaj marrëveshjeje);

- **RCC:** (do të përcaktohet në vijim, në përputhje me dispozitat e nenit 10 (2) të kësaj marrëveshjeje).

- Republika e Sllovenisë:

- **Autoriteti për Kërkim dhe Shpëtim Ajror (SAR):** Administrata e Republikës së Sllovenisë për Mbrojtje Civile dhe Ndihmë ndaj Fatkeqësive;

- RCC-të:

- Shërbimet e Navigimit Ajror të Sllovenisë sh.a.;

- Ministria e Punëve të Brendshme, Policia;

- Ministria e Mbrojtjes, Administrata e Republikës së Sllovenisë për Mbrojtje Civile dhe Ndihmë ndaj Fatkeqësive.

- **MRCC:** Ministria e Infrastrukturës, Administrata Detare e Sllovenisë.

AGREEMENT BETWEEN

THE COUNCIL OF MINISTERS OF BOSNIA AND HERZEGOVINA, THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF BULGARIA, THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF CROATIA, THE GOVERNMENT OF HUNGARY, THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA, THE GOVERNMENT OF MONTENEGRO, THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF SERBIA, THE GOVERNMENT OF THE SLOVAK REPUBLIC AND THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF SLOVENIA

ON

AERONAUTICAL SEARCH AND RESCUE COOPERATION AND COORDINATION

The Council of Ministers of **Bosnia and Herzegovina**, the Government of **the Republic of Bulgaria**, the Government of the **Republic of Croatia**, the Government of **Hungary**, the Government of the **Republic of North Macedonia**, the Government of **Montenegro**, the Government of the **Republic of Serbia**, the Government of the **Slovak Republic** and the Government of the **Republic of Slovenia** (*hereinafter referred to as "the Parties"*),

Considering that the Convention on International Civil Aviation opened for signature at Chicago on the seventh day of December 1944 (*hereinafter referred to as "the Chicago Convention"*) and its Annexes provide the essential framework for an international civil aviation system on Search and Rescue (*hereinafter referred to as "SAR"*) operations,

Bearing in mind the importance of SAR, as an operation to retrieve persons in distress, provide for their initial medical or other needs, and deliver them to a place of safety,

Being aware that immediate rescue measures are of vital importance for persons in distress,

Recognising the necessity of full compliance with the Standards and Recommended Practices of the International Civil Aviation Organization (*hereinafter referred to as "ICAO SARPs"*) in the area of SAR, set out in Annex 12 to the Chicago Convention on Search and Rescue (*hereinafter referred to as "Annex 12"*), and further developed in the International Aeronautical and Maritime Search and Rescue Manual (IAMSAR) and other related SAR documents (*hereinafter referred to as "the international SAR provisions"*),

Recognising that Annex 12 is applicable to the establishment, maintenance and operation of SAR services in the territories of the States of the Parties and over the High Seas, and to the coordination of such services between States,

Having regard to the ICAO SARPs set out in Annex 9 to the Chicago Convention on Facilitation, and in particular Chapter 8 on the facilitation of, *inter alia*, search and rescue,

Recognising the need for harmonising and strengthening international cooperation and especially regional cooperation for the efficient organisation and conduct of aeronautical SAR operations and associated training,

Recognising the provisions laid down in the Memorandum of Understanding (*hereinafter referred to as "MoU"*), which was signed on 3 November 2016 in Belgrade, on the establishment of the Regional Aeronautical SAR Advisory Committee.

Considering that the Parties to this Agreement are, at the same time, Members or Observers to the Regional Aeronautical SAR Advisory Committee.

Have agreed as follows:

Article 1 – Objective and scope

This Agreement establishes a framework for cooperation among the Parties in conducting aeronautical SAR operations and sets out their various respective responsibilities in order to fully comply with their obligations as set out in ICAO SARPs.

The Parties agree that aeronautical SAR operations in or over the territorial sea, internal waters and land of the State each Party are to be carried out in accordance with the national legislation or legislation in force in the territories of the States of the respective Parties, taking into account the relevant international SAR provisions.

The Parties shall ensure close coordination with their respective national aeronautical SAR authorities to help promote common and effective SAR services under this Agreement in assisting each other, to the extent possible, in the conduct of SAR operations by authorising their Rescue Coordination Centres (hereinafter: RCCs) to request assistance from the RCC of the other Party or to promptly respond to distress calls and requests for assistance from the RCC of the other Party.

Terms and definitions shall for the purpose of this Agreement have the meaning laid down in Chapter 1 of the Annex 12.

Article 2 – SAR regions

For aeronautical SAR purposes the boundaries of neighbouring SAR regions shall, in principle and in so far as practicable, coincide with the corresponding boundaries between the States of the Parties' Flight Information Regions (*hereinafter referred to as "FIR"*).

Situations where the FIRs and the SAR regions do not correspond will be detailed in the separate bilateral agreement between the Parties concerned. The Contracting Parties of the later shall notify the depositary of this Agreement through diplomatic channels about the conclusion of internal procedures of such agreement. The depositary of this Agreement shall inform Parties on the conclusion on any of such bilateral agreement.

The delineation of the SAR regions between the Parties as defined in the paragraph 1 of this Article is to ensure the availability of SAR services, to improve or simplify SAR operations, and to facilitate proper distribution of distress alerts to RCCs. Hence, it is not related to and shall not prejudice the delineation of any other boundary between the Parties.

Article 3 – Authorities / [Entity]

The responsible aeronautical SAR authorities, RCCs and Maritime Rescue Coordination Centres (hereinafter: MRRCs) of the Parties are listed in the Annex of this Agreement.

Article 4 – Communication and cooperation

To ensure the proper coordination of SAR operations, the Parties should keep each other fully and promptly informed. If the RCC of a State of a Party considers that assistance from the RCCs of a State of an another Party is needed, it may request such assistance.

If the RCC of a State of a Party receives information that human life is, or is believed to be, in distress within the SAR region of the State of one of the other Parties, that RCC shall, without delay, inform the RCC of the State of the other Party (-ies) concerned. Assistance to any aircraft either in distress or believed to be in distress, and to survivors of an aircraft accident within the SAR region of any Party, shall be rendered regardless of the State of registry or status of the aircraft, or the nationality or status of the persons in the aircraft, or the circumstances in which the aircraft or persons are found.

Article 5 – Facilitation of transit through the territory of the States of the Parties

Subject to conditions imposed by Annex 12, each Party will allow emergency transit without delay to the SAR units of another Party through or over its State's territorial sea, internal waters and land for the purpose of conducting SAR operations.

Article 6 – Operational agreements

The responsible authorities [entities], as defined in the Annex to this Agreement, shall conclude bilateral operational agreements on cooperation for the practical implementation of this Agreement with the responsible authorities of all the neighbouring States Parties of this Agreement. Such cooperation shall include, *inter alia*, joint SAR exercises and training, regular checks of relevant communication channels, liaison visits by SAR experts, the exchange of SAR information, procedures, techniques and experiences, and coordinating national positions on international SAR issues of mutual interest. The Parties shall establish appropriate procedures in the operational agreement to provide for the most effective and efficient means of communication.

The responsible authorities shall lay down detailed measures in the operational agreement in order to facilitate border crossings, stopovers in the territory of the State of another Party and the temporary import/export of aircraft, tools, spare parts and equipment required in search and rescue operations.

The temporary admission of items described shall be relieved from customs duties and other import duties and charges value add taxes, in accordance with the national legislation of the Parties.

Unless otherwise agreed between the Parties in the operational agreements, the carrying of weapons, ammunition and explosive ordnance is not allowed in the course of the SAR operations under this Agreement.

Article 7 – Costs

The Parties shall resolve the issue of bearing the expenses incurred by their participation in SAR operations in the operational agreement in accordance with the national legislation or legislation in force in the territories of the States of the Parties.

If the issue of bearing the expenses is not defined by the operational agreement or bilateral agreements, each Party shall bear the expenses incurred by its participation in SAR operations in conformity with this Agreement.

If, in the course of a SAR operation in conformity with this Agreement, damage is caused to a third party, the Party requiring assistance shall assume the responsibility as if the damage were caused by the members of its SAR units participating in the SAR operation, unless the damage is caused intentionally or through gross negligence.

Article 8 – Rights and obligations

Nothing in this Agreement shall affect in any way the rights and obligations of any Party, arising from international agreements or other arrangements between the Parties

Parties shall not transfer their rights, obligations and participation in this Agreement to other entities without the expressed consent of all the Parties.

All activities conducted under this Agreement are subject to the regulations and policies of the States of the Parties and to all laws, regulations and policies to which the Parties are subject.

Article 9 - Consultations

In the spirit of close cooperation, each Party shall consult with one another from time to time, with a view to ensuring the implementation of satisfactory compliance with the provisions of this Agreement and the Annex thereto, and any Party may at any time request consultations on the implementation, interpretation, application or amendment of this Agreement. No dispute shall be referred to an international body or third party for settlement.

Such consultations, which may transpire through discussion or correspondence, shall begin within a period of sixty (60) days from the date of the receipt of such a request, unless otherwise agreed by Parties.

Article 10 - Amendment of the Agreement

If any Party considers it desirable to amend any provision of this Agreement, such amendment shall be agreed upon in accordance with the provisions of Article 9. Such amendment shall enter into force when the Parties have notified each other through diplomatic channels on the fulfilment of their internal legal procedures relating to the conclusion and the entry into force of the international agreement.

Notwithstanding the provisions of paragraph (1) above, each Party may amend its SAR authorities as listed in the Annex to this Agreement. Such amendment shall enter into force when this Party notifies other Parties through diplomatic channels on the amendment of the Annex.

The term "Agreement" means this Agreement, its Annex and any amendment to the Agreement or to the Annex. The term "Annex" means the list of SAR Authorities, the list of RCCs and/or MRCCs of the States of the Parties.

Article 11 - Entry into force, duration and withdrawal

This Agreement shall be subject to ratification, acceptance or approval by the Parties in accordance with their respective national legislations.

This Agreement shall enter into force on the first day of the month following the date on which the third Party has deposited its instrument of ratification, acceptance or approval with the Depositary.

For the Party that ratifies, accepts or approves this Agreement after the date of its entry into force, in accordance with the Paragraph 2 of this Article, this Agreement shall enter into force for that Party on the first day of the month following the date of deposit of its instrument of ratification, acceptance or approval with the Depositary.

This Agreement is concluded for an indefinite period of time.

Any Party may withdraw from this Agreement at any time by written notification of withdrawal to the Depositary. The withdrawal shall take effect six months after the receipt of the notification by the Depositary.

Article 12 – Settlement of Disputes

In case of a dispute between two or more Parties concerning the interpretation or application of this Agreement, the Parties concerned shall seek a solution through the mutual consultations and negotiations and shall not refer to an international body or third party for settlement.

Article 13 - Accession

After the entry into force of this Agreement, this Agreement shall be opened for accession.

For the accession Party, this Agreement shall enter into force on the first day of the month following the date of the deposit of its instrument of accession with the Depositary.

The accession Party shall be an ICAO Contracting State.

Article 14 – Depositary

The Government of the Republic of Serbia shall act as the Depositary of this Agreement.

Upon its entry into force in accordance with the provisions of the paragraph 2 of Article 11, this Agreement and any amendments thereto shall be registered by the Depositary with the International Civil Aviation Organization (ICAO).

Article 15 – Final Provision

If the need to exchange sensitive information arises, the Parties may use as a guideline the Policy on the Confidentiality, Protection and Appropriate Use of Information Relative to the Activities of the Regional Aeronautical SAR Advisory Committee.

IN WITNESS WHEREOF, the undersigned, being duly authorized by their respective governments have signed this Agreement.

The original of this Agreement in a single original in the English language shall be deposited with the Depositary which shall transmit a certified copy thereto to each Party.

Done at Ohrid on 22/02/2023

For the Council of Ministers of **Bosnia and Herzegovina**

For the Government of **Montenegro**

For the Government of the **Republic of Bulgaria**

For the Government of the **Republic of Serbia**

For the Government of the **Republic of Croatia**

For the Government of the **Slovak Republic**

For the Government of **Hungary**

For the Government of the **Republic of Slovenia**

For the Government of the **Republic of North Macedonia**

ANNEX

SAR Authorities, RCCs and MRCCs

Bosnia and Herzegovina:

- Aeronautical SAR Authority: Bosnia and Herzegovina Directorate of Civil Aviation (BHDCA);
- RCC: Rescue Coordination Centre of Bosnia and Herzegovina (BHRCC), Bosnia and Herzegovina Air Navigation Services Agency (BHANSA);

Republic of Bulgaria:

- Aeronautical SAR Authority: Directorate General Civil Aviation Administration, The Republic of Bulgaria;
- RCC: RCC Varna;

Republic of Croatia:

- Aeronautical SAR Authority: Civil Protection Directorate, Ministry of the Interior, Republic of Croatia;
- RCC: Operational Centre, Civil Protection Directorate, Ministry of the Interior, Republic of Croatia;
- MRCC: MRCC Rijeka;

Hungary:

- Aeronautical SAR Authority: Ministry of Interior of Hungary;
- RCC: Hungarian Defence Forces Air Operation Command and Control Centre, Air Operation Centre;

Republic of North Macedonia:

- Aeronautical SAR Authority: Civil Aviation Agency of the Republic of North Macedonia;
- RCC: RCC Skopje;

Montenegro:

- SAR Authority:
 - o SAR Authority responsible for land:
 - Ministry of the Interior of Montenegro;
Directorate for Protection and Rescue;
Department 112 – Operational communication centre 112;
 - o SAR Authority responsible at the sea:
 - Ministry of Capital Investments of Montenegro;
Administration for Maritime Safety and Port Management;
Sector for Safety of Navigation;
 - o Authority responsible for SAR oversight:
 - Civil Aviation Agency Montenegro;
- RCC: Operational communication centre 112 – Aeronautical Rescue Coordination Centre of Directorate for Protection and Rescue of Ministry of the Interior;
- MRCC: Maritime Rescue Coordination Centre of Administration for Maritime Safety and Port Management of Ministry of Capital Investments;

Republic of Serbia:

- Aeronautical SAR Authority: Civil Aviation Directorate of the Republic of Serbia;
- RCC: Rescue Coordination Centre Belgrade of the Civil Aviation Directorate of the Republic of Serbia;

Slovak Republic:

- Aeronautical SAR Authority: *(will be subsequently listed, in accordance with the provisions of Article 10 (2) of this Agreement);*
- RCC: *(will be subsequently listed, in accordance with the provisions of Article 10 (2) of this Agreement);*

Republic of Slovenia:

- Aeronautical SAR Authority: Administration of the Republic of Slovenia for Civil Protection and Disaster Relief;
- RCCs:
 - o Slovenian Air Navigation Services, Limited;
 - o Ministry of the Interior, Police;
 - o Ministry of Defence, Administration of the Republic of Slovenia for Civil Protection and Disaster Relief;
- MRCC: Ministry of Infrastructure, Slovenian Maritime Administration;